

# **PROJEKTI I KADASTRIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME DHE INFRASTRUKTURËS GJEOHAPËSINORE TË KOSOVËS (REGIP)**

## **Termet e Referencës për:**

**Gjashtë (6) Ekspertë Vendorë si anëtarë të nënkomisioneve për të mbështetur Komisionin në shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për zyrtarizmin e gjendjes faktike dhe mospërputhjet me Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme (Komisioni)**

(Numri i referencës së kontratës: XK-KCA- 439250-CS-INDV )

Qeveria e Kosovës ka marrë një Kredi nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) në vlerë prej 14.60 milion dollarë amerikan për të financuar Projektin e Kadastrit të Pronës së Paluajtshme & Infrastrukturës Gjeohapësinore, që pritet të zbatohet brenda një periudhe pesëvjeçare. Projekti i propozuar synon të ndihmojë Qeverinë e Kosovës që të përmirësojë transparencën dhe cilësinë e administrimit në tokës dhe të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore. Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) është agjencia zbatuese për projektin REGIP, brenda së cilës do të krijohet Njësia për Implementimin e Projektit (NjIP). NjIP do të ketë personel të përbërë nga Udhëheqësi i NjIP-it, Specialisti i Prokurimit, Specialisti i Menaxhimit Financiar, Specialist i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, Specialisti Ligjor dhe personel tjetër teknik, si ekspertë të GIS/Kadastrit, etj. NjIP do të jetë përgjegjëse për implementimin e përditshëm të projektit dhe për ofrimin e mbikëqyrjes teknike specifike të aktiviteteve. Ajo do të mbikëqyrë të gjitha aspektet e projektit, duke përfshirë prokurimin, menaxhimin financiar, monitorimin dhe vlerësimin, si dhe masat mbrojtëse të projektit.

Në kuadër të REGIP-it, një nga aktivitetet kryesore është projekti i Rindërtimit të Informacionit Kadastral (RIK). RIK është planifikuar të zbatohet deri në 120 zona kadastrale me prioritet.

RIK do të zbatohet nga operatorët ekonomikë të kontraktuar që do të rindërtojnë informacionin kadastral në zonat e përcaktuara kadastrale. Aktivitetet e kryera nga operatorët ekonomikë do të monitorohen nga kontraktori i kontrollit të cilësisë.

Bazuar në nenin 42 të Ligjit Nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, AKK do të themelojë nënkomisioneve për përmbushjen e obligimeve që dalin nga procesi i rindërtimit dhe për të ofruar mbështetje për Komisionin gjatë këtij procesi.

NjIP aktualisht është duke kërkuar gjashtë (6) ekspertë vendorë: katër (4) në fushën ligjore të së drejtës pronësore dhe dy (2) në fushën e kadastrës.

## **Përshkrimi i detyrave të punës dhe përgjegjësitë**

Përgjegjësitë e ekspertëve vendorë të cilët do të jenë pjesë e nënkomisioneve për të mbështetur Komisionin për Rindërtimin e Informacionit Kadastral janë të përcaktuara në nenin 42 të Ligjit nr. 08/L-237 për Kadastrin e Pronës së Paluajtshme dhe nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MESPI) Nr. 08/2024 për Komisionet dhe Nënkomisionet për Rindërtimin e Informacionit Kadastral dhe Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme, si dhe çdo detyrë tjetër të kërkuar nga AKK-ja apo Komisioni i RIK-ut.

Ekspertët do të vendosen në objektet e AKK-së në Prishtinë, por duhet të jenë të gatshëm të udhëtojnë në lokacione të ndryshme të projektit në mbarë vendin, të mbajnë takime të shumta dhe të punojnë nën presion. Transporti do të sigurohet nga AKK.

### a) Ekspert Ligjor (4)

Si anëtar i nënkomisionit, Eksperti Ligjor:

- Shqyrton rastet për njohjen dhe zyrtarizmin e të drejtave pronësore të pakontestueshme mbi pronat e paluajtshme në rastet e trashëgimisë së paformalizuar;
- Shqyrton rastet për njohjen e pronësisë në rastet e shitblerjeve sipas marrëveshjes jo formale/ gojore, të cilat kanë mbetur të pazyrtarizuara para fillimit të projektit RIK dhe i propozon Komisionit aprovimin apo refuzimin e tyre;
- Përgatit në bashkëpunim me Operatorin Ekonomik dhe propozon hapjen e shikimit publik duke përfshirë shpalljen e datës, organizimin dhe udhëheqjen e inspektimit publik;
- Merr deklaratatë të palëve, siguron dokumentacionin dhe provat e nevojshme për vendimmarrje;
- Mbështet Komisionin në shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të pronarëve, përgatitë mbajtjen e seancave dëgjimore për shqyrtimin e kërkesave apo ankesave dhe nxjerrjen e vendimeve për secilin rast të paraqitur gjatë shikimit publik;
- Shqyrton rastet e plotësimit ose korigjimit të të dhënave kur të dhënat kadastrale nuk janë të plota apo janë me gabime dhe ia dërgon komisionit për aprovim;
- Përgatitë dhe propozon kohën dhe vendin për informim publik për banorët e ZK të përfshira në projekt;
- Bashkëpunon me institucionet dhe personat me autorizime publike për shfrytëzimin e të dhënave të nevojshme për sigurimin e dokumentacionit dhe provave për vendimmarrje për korigjimin e të dhënave kadastrale jo të plota apo me gabime;
- Për punët e kryera i përgjigjen komisionit. Puna që kryhet nga nën-komisionet shqyrtohet dhe aprovohet nga komisioni.

## b) Ekspert Kadastral (2)

Si anëtar i nënkomisionit, Eksperti Kadastral bën:

- Shqyrtimin dhe vendosjen e rasteve që kanë të bëjnë me plotësimin ose korrigjimin e të dhënave në kadastrë gjatë projektit;
- Kontrollin e zbatimit të planit të informimit publik dhe materialeve të përgatitura nga OE për informimin publik;
- Përgatitja e raporteve të punës për AKK dhe institucionet tjera përgjegjëse lidhur me ecurinë e zbatimit të projektit;
- Shqyrton rastet për njohjen dhe zyrtarizmin e të drejtave pronësore jokontestimore mbi pronat e paluajtshme për rastet e trashëgimive të paformalizuara;
- Si anëtar i nënkomisionit përgatitë, në bashkëpunim me OE dhe propozon hapjen e shikimit publik, përfshirë shpalljen e datës, organizimin dhe udhëheqjen e shikimit publik;
- Merr deklaratë të palëve, siguron dokumentacionin dhe provat e nevojshme për vendimmarrje;
- Si anëtar i nënkomisionit mbështetë Komisionin në shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të pronarëve;
- Shqyrton rastet e plotësimit ose korrigjimit të të dhënave kur të dhënat kadastrale nuk janë të plota apo janë me gabime dhe ia dërgon komisionit për aprovim;
- Përgatitë dhe propozon kohën dhe vendin për informim publik për banorët e zonave kadastrale të përfshira në projekt;
- Bashkëpunon me institucionet dhe personat me autorizime publike për shfrytëzimin e të dhënave të nevojshme për sigurimin e dokumentacionit dhe provave për vendimmarrje për korrigjimin e të dhënave kadastrale jo të plota apo me gabime;
- Për punët e kryera i përgjigjet komisionit për rindërtim.

## Ekspert Ligjor (4)

### Kualifikimet e kërkuara

- Diplomë universitare në juridik;
- Së paku tri (3) vite përvojë profesionale përkatëse në të drejtën e pasurive të paluajtshme;
- Njohuri të mira të ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës për regjistrimin e të drejtave pronësore dhe kadastrin;
- Aftësi të shkëlqyera hartuese, analitike, komunikuese, koordinuese dhe ndërpersonale.
- Kërkohet njohja e rrjedhshme e gjuhës shqipe;
- Njohja e gjuhës angleze dhe serbe është përparësi;

- Njohuri të shkëlqyera të aplikacioneve kompjuterike (Word, Excel)

## **Ekspert Kadastral (2)**

### **Kualifikimet e kërkuara**

- Baçelor në Gjeodezi;
- Të paktën tri (3) vite përvojë pune në aktivitete të ngjashme, dhe së paku 2 vite përvojë specifike në kadastër;
- Aftësi të shkëlqyera hartuese, analitike, komunikuese, koordinuese dhe ndërpersonale.
- Kërkohet njohja e rrjedhshme e gjuhës shqipe;
- Njohja e gjuhës angleze dhe serbe është përparësi;
- Njohuri të shkëlqyera të aplikacioneve kompjuterike (Word, Excel))

### **Rezultatet e punës**

Rezultati kryesor i punës së kryer në mënyrë profesionale, duhet të mbështesë në mënyrë të kënaqshme Komisionin kryesor të RIK gjatë zbatimit të projektit.

Sa i përket përmbushjes së detyrave të përshkruara në përshkrimin e detyrave të punës dhe përgjegjësi, ekspertëve vendorë do t'u kërkohet të përgatisin dhe dorëzojnë raportet e punës për detyrat e specifikuar, në përputhje me planin e zbatimit të RIK-ut, në koordinim me Komisionin e RIK-ut.

### **Kushtet e punës dhe periudha e performancës**

Ekspertët vendor të rekrutuar do të punojnë me orar të plotë (8 orë), dhe kohëzgjatja e kontratës pritet të jetë deri në fund të projektit REGIP (31 gusht 2025), me mundësi vazhdimi në bazë të datës së mbylljes së projektit. Vazhdimi i kontratës do t'i nënshtrohet performancës së kënaqshme për të cilën është rënë dakord gjatë vlerësimit zyrtar të planifikuar. Pagesa do të bëhet në bazë të shumës mujore të rënë dakord në kontratë. Ekspert pritet të fillojë shërbimet pas nënshkrimit të kontratës. Ekspertët do të vendosen në objektet e AKK-së në Prishtinë, por duhet të jenë të gatshëm të udhëtojnë në lokacione të ndryshme të projektit në mbarë vendin, të mbajnë takime të shumta dhe të punojnë nën presion.

### **Raportimi**

Ekspertët vendor do t'i raportojnë Kryetarit të Komisionit të RIK-ut dhe do të dorëzojnë raportin mujor të vijueshmërisë në punë për të llogaritur ditët aktuale të punës gjatë muajit kalendarik,

## **Procesi i përzgjedhjes**

Individët me përvojë dhe të kualifikuar do të përzgjidhen sipas dispozitave të Rregulloreve të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e Financimit të Projekteve Investuese (FPI), të nxjerra në korrik të vitit 2016 dhe të rishikuara në nëntor të viti 2017 dhe gusht të vitit 2018, bazuar në thirrjen e hapur për përzgjedhje të Konsulentëve Individual.

Agjencia Kadastrale e Kosovës është e përkushtuar ndaj parimeve të mundësive të barabarta të punësimit dhe po ashtu është e përkushtuar që të marrë vendime për punësim në bazë të meritave. Jemi të përkushtuar të zbatojmë ligjet e shtetit që ofrojnë mundësi të barabarta punësimi, si dhe të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me kushtet e punësimit. Agjencia dëshiron të mbajë një mjedis pune pa ngacmime seksuale dhe pa diskriminim në bazë të racës, fesë, ngjyrës, origjinës kombëtare, orientimit seksual, aftësive të kufizuara fizike dhe mendore, statusit martesor, moshës ose ndonjë kushti tjetër të mbrojtur nga ligjet e shtetit.